



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 36

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Prishtinë, më 21 korrik 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Mirjeta Kalludra, Besa Baftiu dhe Adem Hoxha.

Munguan: Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Të ftuar: Arban Abrashi, ministër i Mistrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS, Izedin Bytyçi, sekretar i MPMS-së, Drin Haraqia, këshilltar i ministrit të MPMS-së, Fatmir Haxholli, këshilltar i Ministrit të MPMS-së.

Sejdi Hoxha, kryeshef Ekzekutiv i Postës së Kosovës, Xhevdet Smakiqi, Posta e Kosovës dhe Hasim Krasniqi, Posta e Kosovës.

Pjesëmarrës të tjerë: Albert Krasniqi-KDI, Agnesa haxhiu-KDI dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim i kërkesës së Postës së Kosovës për shpërndarjen e pensioneve dhe skemave sociale;
3. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Diskutim i kërkesës së Postës së Kosovës për shpërndarjen e pensioneve dhe skemave sociale

Kryetarja: Fillimisht me lejoni të ju përshëndes, i nderuar z. Hoxha, kryeshef Ekzekutiv i Postës së Kosovës, si dhe përfaqësuesit e tjerë të Postës së Kosovës. Njëherit ju falënderojmë që keni gjetur kohë dhe ju keni përgjigjur ftesës së Komisionit Parlamentar për të diskutuar kërkesën e Postës së Kosovës lidhur me shpërndarjen e skemave Sociale. Ne, sot, në këtë takim i kemi ftuar edhe dy ministrat, ministrin e Ministrisë së Financave, z. Avdullah Hotin, mirëpo ende nuk kemi marrë një konfirmim për prezencën e tij, po ashtu kemi ftuar edhe ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, i cili e ka konfirmuar se do të raportojë sot në komision. Pra, ky takim sot do të zhvillohet në dy pjesë, ku në pjesën e parë e kemi ftuar z. Sejdi Hoxha, kryeshefin Ekzekutiv të Postës së Kosovës, kurse në pjesën e dytë ministrat me të cilët do të diskutojmë çështjen e shpërndarjes së skemave sociale.

Atëherë si Komision Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ju kemi ftuar për të diskutuar apo prezantuar me detaje kërkesën e Postës së Kosovës lidhur me mos nënshkrimin e marrëveshjes me MPMS-në për shpërndarjen e skemave sociale të cilat menaxhohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Po ashtu në kërkesën tuaj keni shprehur shqetësimin tuaj lidhur me mos nënshkrimin e marrëveshjes të cilën e keni negociuar me MPMS gati për një vit siç keni prezantuar në shkresën tuaj. Pra, fjala është për shpërndarjen e skemave sociale të cilat menaxhohen nga MPMS, personat të cilët i mbështet shteti me ligj e të cilët ballafaqohen me një situatë jo shumë humane nëpër sportelet e bankave komerciale duke pritur në rreshta të gjata e në ditë të caktuara gjatë dimrit dhe verës dhe gjendja e tyre shëndetësore edhe sociale nuk është e përshtatshme. Ne disa herë e kemi trajtuar këtë çështje dhe i kemi bërë edhe pyetje edhe ministrit pse nuk është gjetur një formë tjetër e shpërndarjes së këtyre skemave sociale në këtë rast të ju dërgohet përmes postës që është një ndërmarrje publike dhe ne jo vetëm që do të bënim një punë të mirë për pensionistet por do t'i ndihmonim edhe postës përgjigjja nuk ka qenë konkrete dhe për këtë arsye ju kemi ftuar që të njoftohemi nga afër lidhur me këtë çështje dhe të kuptojmë realitetin pse këto skema s'po shpërndahen nga posta.

Atëherë fjalën ia japim kryeshefit të Postës së Kosovës, z. Sejdi Hoxha, të prezantojë kërkesën e tyre lidhur me shpërndarjen e skemave sociale.

Sejdi Hoxha –Kryeshef Ekzekutiv i Postës së Kosovës: Ju faleminderit e nderuara kryetare, të nderuar deputetë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të mediave dhe ju të pranishëm. Fillimisht më lejoni t'ju falënderoj në emër të njëmijë punonjëseve të Postës së Kosovës që keni gjetur kohë që si Komision Parlamentar të trajtoni këtë çështje, e cila është me interes edhe për përfituesit apo qytetarët tanë, natyrisht edhe për institucionin të cilin ne e përfaqësojmë. Me mua

prezent është Xhevdet Smakiqi, drejtor i zyrës ligjore dhe Hasim Krasniqi, drejtor i prokurimit në Postën e Kosovës. Unë fillimisht në pika të shkurta do të sqarojë problemin ose çështjen e shpërndarjes së skemave sociale. Ne këtë projekt e kemi filluar me MPMS-në në vitin 2014 kur ministër ka qenë z. Nenad Rashiq, pastaj e kemi diskutuar edhe me ministrin e ri z. Arban Abrashi dhe i kemi themeluar dy grupe punuese të cilat kanë qenë të përbëra nga ekspertet e IT-së, Juristët Ekonomistët financiarë etj. Dhe ideja ka qenë që përmes këtyre grupeve punuese të hartojmë një draft -final të kësaj marrëveshje. Pasi që janë kryer të gjitha testimet në e-mailin zyrtar janë bërë konfirmimet zyrtare edhe nga Ministria edhe nga Posta. Unë këtu me vete kam një konfirmim nga znj. Minire Begaj e cila është drejtoreshë e çështjeve ligjore në MPMS e cila ka konfirmuar draftin e marrëveshjes dhe ka rekomanduar që janë kryer të gjitha testimet edhe në kuptimin teknik edhe operacional që posta mund ta kryejë një aktivitet të tillë. Pas këtyre dakordimeve përmes komunikimit zyrtar e-mailave që janë bërë mes dy ekipeve punuese kemi ardhur deri të drafti i marrëveshjes (të cilin mund t'ua afrojmë) i cili është hartuar nga dy institucionet dhe pas përfundimit të këtij drafti më: 28.05.2015. Ne jemi ftuar nga ministri që në ora 14:00 të nënshkruajmë marrëveshjen e mirëkuptimit. Fatkeqësisht në rrugë e sipër duke shkuar me nënshkruar marrëveshjen jemi informuar se ka një stopim të procesit nga Ministria e Financave, pa dhënë ndonjë sqarim më hollësisht. Se duhet stopohet ky proces dhe duhet analizohet përsëri. Ne përsëri kemi diskutuar dhe jemi takuar me ministrin, z. Abrashi dhe na është kërkuar që t'i përmbushim tri kritere. Kriteri 1. Duhet të dokumentoni nga Banka Qendrore e Kosovës-BQK që Posta e Kosovës posedon licencë për të kryer një shërbim të tillë. Ne natyrisht që ne e kemi kontaktuar BQK-në dhe kemi marrë interpretimin ligjor nga BQK-ja, z. Dardan Fusha, që është drejtor i Licencimit dhe Standardizimit, që Posta e Kosovës posedon licencën për të kryer një aktivitet të tillë dhe këtë konfirmim zyrtarë që ne e kemi këtë mund të prezantojmë kudo e ka edhe MPMS-ja. Pra, kriteri parë që është kërkuar nga MPMS-ja është plotësuar. Kriteri 2. ka qenë nga Thesari i Shtetit do të thotë që ata mund t'i derdhin mjetet në llogarinë e Postës së Kosovës. Ne e kemi marrë konfirmimin me shkrim nga drejtori i thesarit, z. Fatmir Plakiqi, i cili thotë se nëse dakordohet Posta e Kosovës me ministrin për ne thesarin nuk është asnjë problem që t'i bartim mjetet dhe është konfirmimi tjetër zyrtar nga drejtori i departamentit të thesarit ku edhe këtë konfirmim ja kemi prezantuar MPMS-së. Kriteri 3. që është kërkuar nga MPMS-ja ka qenë që të konsultohet Komisioni Rregullator për Prokurim Publik-KRPP. Ne kemi kërkuar nga ta që a mundet ministria si institucion duke marrë parasysh që Posta e Kosovës që është ndërmarrje publike të nënshkruaj një marrëveshje me Postën e Kosovës me krye një aktivitet të tillë. Ne kemi kërkuar një interpretim ligjor nga KRPP dhe na është dhënë përmes e-mailit zyrtar, ku na është thënë se meqenëse Posta është institucion publik konform nenit 9 të ligjit të prokurimit i mundësohet Qeverisë që nëse një shërbim kryen një institucion publik pa pasur nevojë të zhvillohen procedurat e prokurimit ajo të kryhet me një institucion të saj në këtë rast siç është Posta e Kosovës. Pra, pas prezantimit të përmbushjes së këtyre tri kritereve është krijuar një realitet i ri dhe normalisht ne kemi komunikuar prapë, mirëpo nuk kemi mundur që të vijmë deri në një konkluzion përfundimtar. Pas gjithë kësaj MPMS-ja shpall tender më 15 dhjetor 2015 për t'i shpërndarë skemat sociale dhe fatkeqësisht në kushtet tenderuese përjashtohet Posta e Kosovës u jepet e drejta që të aplikojnë vetëm Bankat që janë të licencuar në Kosovë, ndërsa jo Posta e Kosovës. Ne përmes një konferencë për shtyp e kemi shprehur shqetësimin tonë lidhur me përjashtimin nga kjo garë. Ne po ashtu kemi parashtruar ankesë në organin shqyrtues të Prokurimit Publik për diskriminim për kriterin diskriminues i cili i ka dhënë hapësirë vetëm bankave dhe pas shqyrtimit nga paneli shqyrtues i prokurimit ka nxjerrë vendim që e

ka aprovuar kërkesën e Postës së Kosovës dhe i ka anuluar procedurat tenderuese do të thotë që edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit – OSHP, bazuar në legjislacionin në fuqi ka marrë një vendim dhe e ka anuluar procedurën tenderuese të MPMS-së duke e cituar si diskriminuese ndaj postës së Kosovës edhe pse për hir të korrektësisë së mediave dhe opinionit edhe pse ligji e mundëson që të bëhet direkt me Postën e Kosovës marrëveshja ne prapë kemi qenë të gatshëm dhe jemi të gatshëm që të futemi në garë apo konkurrencë të shëndoshë edhe me bankat. Ne e kemi dhënë një premtim publik që momentalisht marrëveshja me Bankën Private për Biznes që e ka MPMS-ja është 1.5 euro për transaksion, kurse në këtë shërbim të kryejmë me 1.30 euro në bazë të numrit të përfituesit të skemave sociale në këtë rast Qeveria do të kursej 63 000 euro në vit. Nuk është vetëm kursimi që bënë qeveria si faktor, por faktor tjetër është që Posta e Kosovës ka 160 zyra postare të cilat janë të shpërndara në tërë territorin e Kosovës në të gjitha komunat e Kosovës përfshirë edhe një pjesë të zonave rurale që s'ka prezencë as një bankë avantazh tjetër është që shumica e zyrave postare punojnë me dy ndërrime dhe punojnë deri në ora 21:00, punojnë edhe vikendeve që në këtë rast qytetarët mund të kryejnë shërbim edhe vikendeve. Posta ka ndryshuar prej që e kemi marrë Licencën për kryerjen e shërbimeve financiare jo bankare e kemi tejkaluar numrin 1 (një) miliard të pagesave që janë bërë në zyrat postare. Është edhe një element me interes që për 10 euro pagese bankat aplikojnë 2.5 deri 3 euro provizion për transaksion që i bije 10 % i pagesës së faturës apo pagesës shkon në provizionin e bankës. Ne ju kemi ofruar qytetarit të Kosovës me 0.5 euro cent një pagesë të tillë. Prej se e kemi lansuar këtë shërbim gjenerojmë diku 100 000 euro të hyra synim i yni është që të rrisim numrin e shërbimeve në Postën e Kosovës, si dhe të garantojmë cilësi në shërbime të ju ndihmojmë këtyre qytetarëve të cilët maltretohen jashtëzakonisht shumë nëpër radhët e pritjes. Ne, si postë, i kemi plotësuar të gjitha kushtet ligjore që kërkohen me ligj ju kemi prezantuar ministrive kemi marrë një rikonfirmim nga OSHP që ka pas diskriminim në procedurat prokuruese OSHP ka marrë vendim dhe e ka anuluar procesin tenderues, pas kësaj ne prapë i kemi shkruar letër ministrit të MPMS-së dhe i kemi kërkuar që të ulemi dhe të gjejmë një zgjidhje përfundimisht këtë shërbim të kalojmë të Posta e Kosovës. Po ashtu dua të ndajë një informatë me ju se me të njëjtën Licencë edhe Posta e Shqipërisë, e Maqedonisë, Malit të Zi dhe të gjitha postat e rajonit i shpërndajnë jo vetëm skemat sociale dhe të gjitha kategoritë e pensioneve në vendet e tyre i shpërndajnë me këtë licencë të cilën e posedojmë edhe ne si postë e Kosovës. Thjesht ne po kërkojmë një shërbim i cili është në interes të institucioneve duke i kursyer qeveria mjetet duke e kryer këtë shërbim, si dhe duke e ndihmuar ndërmarrjen publike të saj që në këtë rast është Posta e Kosovës ku behët fjalë për rreth një shumë gjysmë milioni euro. Edhe njëherë po e përsërisë para jush se jemi të gatshëm me çdo kusht edhe transparencës edhe konkurrencës mi shkua mbrapa natyrisht me zbatuar edhe ligjin duke marrë parasysh që kemi një konfirmim zyrtar nga KRPP i cili i jep të drejtë ministrisë që të nënshkruaj direkt marrëveshjen me postën e Kosovës përmes negocimit dhe pajtimit të përbashkët. Ju kërkojë falje nëse e kam zgjatur, mirëpo dëshirojë të ju prezantojë në detaje kërkesën tonë. Ju faleminderit!

Kryetarja: Ju faleminderit z. Hoxha për këto sqarime. Urdhëroni z. Baxhaku e keni fjalën.

Hatim Baxhaku: Ju faleminderit kryetare, përshëndetje për përfaqësuesit e Postës së Kosovës të cilët ju kanë përgjigjur ftesës së Komisionit për të diskutuar këtë çështje lidhur me shpërndarjen e skemave sociale. Ne, si komision, jemi njoftuar në mbledhjen e kaluar te komisionit lidhur me kërkesën e juaj lidhur me shpërndarjen e skemave sociale. Ne jemi pajtuar shumica prej nesh se

pritja nëpër sportele para bankës e shfrytëzuesve të pensioneve dhe përfituesve të skemave sociale nuk është shumë e kënaqshme, mirëpo unë dua të them qartë se unë kam disa dilema se a mundet të kryej posta këtë shërbim për arsye sepse posta nuk është e licencuar që të jetë pjesë e sistemit bankar, nuk mund të hapë llogari bankare për këta përfitues të skemave sociale. Në këtë rast shfrytëzuesi i pensioneve nuk është në shtëpi apo banesë çka bëhet me pensionin e tij, ku mbetet pensioni i tij. Pra, këtu unë kam dyshimet e mija dhe për këtë arsye se për këtë çështje nuk mund ta kryej këtë shërbim posta. Po ashtu unë kam edhe dyshim të siguria e shpërndarjes me postë mundësia e keqpërdorimeve. Ne jetojmë në Kosovë edhe e dimë që kur parët janë në dorën e njeriut nuk i dorëzohen me kohë përfituesit mund të keqpërdorën apo shfrytëzohen. Nga përparësitë që i ka posta që është me afër shfrytëzuesve unë kamë disa dilema që këtë shërbim për momentin nuk mund ta kryejë Posta e Kosovës. Dhe në rast se kërkohet ndonjë votim në këtë rast unë do të abstenoj deri t'i sqaroj këto çështje me njerëz që e njohin ekonominë dhe sistemin bankar. Ju faleminderit!

Sejdi Hoxha – Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës: Ju faleminderit z. deputet, një sqarim shumë të vogël përfituesit e skemave sociale fillimisht nuk kanë llogari bankare ata i marrin parat kesh në sportelet e bankave, do të thotë se për skemat sociale që jemi duke diskutuar kjo kategori nuk ka farë llogari bankare. Pra, këta do t'i marrin parat kesh në zyrat tona postare, nuk jemi duke biseduar për pjesën për pensione. Ne jemi institucion publik dhe çdo punëtor i joni ka kontratë punë dhe ndëshkohet për gjithçka që vepron jashtë ligjit. Pra, BQK si institucion i Licencimit ka vërtetuar se Posta e Kosovës ka licencë për të kryer këtë punë, pra për këtë kemi dokument. Këta përfitues nuk kanë llogari bankare, pra i marrin të hollat kesh, bile në këtë rast është një periudhë dyditore që nëse ata nuk i tërheqin mjetet për ato dy ditë llogaritë që ata s'kanë nevojë për ato mjete fare. Pra e kanë një periudhë shumë të shkurtër kohore. Kurse të pyetja e dytë apo shqetësim numër dy të keqpërdorimet në bazë të shifrave financiare që i kemi nga auditori i jashtëm i qarkullojmë mbi 8 milionë euro në zyrat tona postare. Në të gjitha zyrat postare i kemi të vendosura kamerat, alarmet dhe sefat e sigurisë se mirë që i kanë edhe bankat realisht, kemi marrëveshje me institucionet përkatëse që e bëjnë bartjen e parave peti-keshit nga zyrat postare në bankat dhe realisht askush prej nesh nuk mund të paragjykojë se do të ketë apo s'do të ketë probleme në momentalisht i qarkullojmë mbi 80 milionë euro vjetore. Ne diku 400 000 euro në ditë i qarkullojmë në ditë diku mbi 10 000 mijë pagesa në zyrat tona postare ne mundemi me marrë si obligim si postë që çdo keqpërdorim mund të ndodhë vjedhje apo keqpërdorim nga ana e punonjësve ne të japim llogari dhe ato mjete i kompensojmë.

Kryetarja: A ka dikush tjetër, të shtojë diçka? Urdhëroni znj. Baftiu.

Besa Baftiu: Faleminderit kryetare. Përshëndetje për drejtorin e postës dhe përfaqësuesit tjerë të postës. Ju faleminderit për kohën që keni gjetur dhe të na jepni sqarimet direkt edhe pse ju këto që i thatë para nesh i kemi dëgjuar edhe përmes mediave edhe e dimë shumë mirë se si ka shkuar ky proces. Është fatkeqësi se si kjo qeveri vazhdon të punojë në dëm të interesave publik, gjegjësisht në dëm të institucioneve publike për çka është e thirrur që të shërbejë apo t'i ndihmojë institucionet publike. Kjo që ka ndodhur me postën, fatkeqësisht shërbimet që i ka kërkuar posta që t'ju afrojë qytetarëve të Republikës së Kosovës edhe me një çmim shumë më të ulët edhe me një shërbim shumë më të mirë më të vërtet është për të ardhur keq. U cek këtu se janë vetëm dy ditë ku qytetarët

janë të obliguar që t'i marrin apo tërheqin skemat sociale. Ato pamjet që i shohim para bankave seriozisht janë pamje tmerruese si shtyhen sepse e kanë afatin e kufizuar. Duke e parë se posta do t'i kryejë shërbimet shumë më mirë edhe me një shumë minimale me të vogël se sa bankat dhe duke parë se Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht shteti i Kosovës po humb një shumë të madhe diku 63 000 euro, siç e cekët, si dhe përfitimin që e ka posta t'i afrojë këto shërbime si institucion publik diku gjysmë milioni euro. Çka mendoni ju si drejtor i postës ku është problemi pse deri në momentin e fundit kur e dinë se edhe përmes mediave është prezantuar se do të fillojë pilot- projekti në komunën e Shtimes ku zv-ministresha e MPMS-së ka deklaruar se do të fillojë ky pilot- projekt për dhënien e shërbimeve nga posta në komunën e Shtimes. Sipas jush çka mendoni pse ka ndodhur e gjithë kjo? Pra, pse në momentin e fundit të gjitha ato që i thatë kriteret që ju kanë kërkuar i keni plotësuar. Ju faleminderit!

Sejdi Hoxha – Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës: Ju faleminderit e nderuara deputete. E potencova me herët, pra nuk e përmenda faktin se me të vërtetë ka qenë publik. Pra, ka qenë takim zyrtar në mes të kryetarit të asociacionit të komunave i cili është njëherit edhe kryetar i Shtimes me zv-ministren e MPMS-së jemi pajtuar se si pilot- projekt me filluar në Shtime për me filluar më operat. Ne i kemi mbi 500 sportele në Postën e Kosovës për të afruar shërbime të tilla. Të them të drejtën e jona si Postë ka qenë kompletimi i të gjitha dokumentacioneve ligjore që kërkohen për ushtrimin e kësaj veprimtarie të tillë. Siç i përmenda licenca konfirmimi nga BQK, konfirmimi nga KRPP, dhe nga Thesari i Shtetit, singërisht për mua nuk kam koment pse në momentin e fundit nuk është nënshkruar marrëveshja. Ndoshta për këtë çështjeje është mirë të pyetni ministrin e MPMS-së. Pyetjet e njëjta që i parashtroji deputeti lidhur me sigurinë në baza vjetore mbi 80 milionë euro i qarkullojmë në vit edhe nëse ka telashe Ministria e Punëve të Brendshme e ka për obligim të na garantojë sigurinë. Ne nuk kemi një përgjigjeje me shkrim, as nuk ftohemi në takim për tu informuar lidhur me arsyen dhe të diskutojmë këtë çështje bashkërisht. Edhe një element që ndoshta është me interes për ju, si deputet, marrëveshjen që e ka MPMS me Bankën Private për Biznes momentalisht është e skaduar dhe si marrëveshje e skaduar është duke vazhduar me u krye ky proces edhe më tutje.

Kryetarja: Ju vazhdimisht po e përmendeni Bankën Private për Biznes-BPB janë edhe bankat e tjera a janë ato me të favorshme për çfarë arsye, edhe sepse BPB është e vetmja Banke vendore. Pyetje: Sa është e saktë që këta pensionist ose përfitues të skemave sociale nuk kanë llogari bankare? Kjo nuk po besoj se qëndron se ata përmes llogarisë i shpërndajnë mjetet. E vërteta është se ju thatë se i keni 500 sporteli në tërë Kosovën. Pyetje: A ka mundësi posta që rastet që janë me të renda përsosna të pa lëvizshme që të ju dërgoni këto mjete në shtëpi?

Fikrim Damka: Ju faleminderit kryetare. I nderuar kryeshef i Postës së Kosovës. Unë kam vetëm një pyetje. A e keni ndonjë marrëveshje me Qeverinë e Kosovës lidhur me shërbimet që jeni duke i kryer për Qeverinë e Kosovës. Në bazë të ligjit jeni të obliguar që t'i kryeni disa shërbime për institucionet e Kosovës, Qeverinë e Kosovës bartjen e disa letrave dhe gjerave tjera e keni një marrëveshje sa është e zbatueshme kjo marrëveshja sa qeveria e mbanë përgjegjësin ndaj jush si postë apo ndërmarrje publike ? Ju faleminderit!

Mirjet Kalludra: Ju faleminderit kryetare. Përshëndetje për përfaqësuesit e Postës së Kosovës dhe ju të pranishëm. Siç e potencoi edhe kryetarja dhe koleget tjerë nuk janë të këndshme ato pamjet e pritjeve të qytetareve para sporteleve të bankave. Mirëpo unë kisha një dilemë rreth kësaj se si pensionistët nuk kanë mundësi që t'i marrin mjetet dhe autorizojnë personat X për marrjen e mjeteve si do të arrini ju që t'i administroni këto autorizime pasi që dihet se është shumë vështirë të vërtetohen apo të bëhet autorizimi i këtyre personave nga ana e pensionistëve?

Sejdi Hoxha – Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës: Ju faleminderit të nderuar deputetë për pyetjet. Pse vetëm Banka Private e Biznesit për skemat sociale MPMS ka marrëveshje ekskluzive që skemat sociale t'i shpërndajë vetëm përmes BPB-së për të cilën nuk e dimë se sa filiale i ka në Kosovë. Ka rast që prej një komunë duhet me shkuar në komunën tjetër që me marrë skemën sociale dhe mi harxhuar 10 % të pensionit të vet për me tërheq. Do të thotë se marrëveshja është ekskluzivë BPB-ja ka ekskluzivitet në shpërndarjen e asistencave sociale. Kurse sa i përket çështjes se a kanë a po nuk kanë llogari bankare me përgjegjësi publike 100 % jam i saktë se nuk kanë llogari bankare pensionistet personat që përfitojnë asistencë sociale, bile e kanë edhe kohën e limituar për të ta kryer shërbimin. Afati i shpërndarjes është dy ditë. Rastet që janë të pa lëvizshëm dhe që duhet të trajtohen me prioritet natyrisht që ne nuk do të marrim shumë risk menaxherial që të gjithë atyre përfituesve e kanë shëndetin e mirë të ju dërgojmë në shtëpi, por që rastet që janë shumë të rënda dhe që deklarohen ne mundemi të ua dërgojmë edhe në shtëpi. Shuma e skemës është 80 euro nuk është ndonjë shumë e madhe që ne do të marrim përgjegjësi që për këto raste të ju dërgojmë edhe në shtëpi përmes formularëve që i bëjmë bashkërisht me ministrin. Çështja e shërbimeve shtetërore kemi prezantuar një model në qeveri të Qeverisë Shqiptare e cila ka marrë një vendim që të gjitha shërbimet shtetërore që i bënë qeveria t'ia kaloj Postës Shqiptare. Për shembull: të gjitha gjobat e trafikut në Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë të paguhen vetëm në zyrat postare, të gjitha semestrat e universiteteve publike që paguajnë studentet tanë t'i paguajnë vetëm në zyrat postare. Për këto që po i theksoj janë vendime dhe shërbime që i ofrojnë postat e rajonit vetëm posta e Kosovës nuk i kryen. Me të drejtë e ngriti deputeti z. Damka shërbimet shtetërore se si e trajtohen qeveria një ndërmarrje publike, çmimi për shërbim postar për ta dërguar një letër prej Prishtinës deri në Dragash si zonë e lartë kushton 0.40 cent dhe Posta e Kosovës në bazë të ligjit mbi shërbimet postare nuk guxon asnjë qytetari t'ia dërgojë letrën në Dragash, ndërsa jemi të obliguar në baza ditore makina e jonë të shkoj në Dragash, qoftë edhe për dy dërgesa për arsye se humbin afatet apo terminet në gjykata, prokurori e biznese. Ne jemi të obliguar që çdo ditë t'i frekuentojmë këto vende. Ligji për shërbimin postar thotë që momentin që posta krijon humbje nga ky shërbim qeveria duhet ta mbulojë këtë humbje, le të shkojë dikush të bizneset që ofrojnë shërbime postare, si DHL ose FedEx dhe le të shohë se apo e dërgon apo jo dhe në këtë rast Posta e Kosovës çdo dite harxhojnë apo shpenzon ekstra mjete financiare i cili ligjërisht duhet të mbulohet nga Qeveria e Kosovës, sepse ne krijojmë humbje duke i dërguar dy letra prej Prishtinës në Dragash ose në zonat tjera të Kosovës që i kemi rreth 40 komuna. Në këtë rast jemi dëmtuar në të dy aspektet edhe në mos kalimin e shërbimeve shtetërore edhe në mos lejimin e kryerjes së atyre shërbimeve që ne i kemi mundësitë. Merreni rastin e Ministrisë së Punëve të Jashtme që kontratën për dërgimin e letrave nëpër ambasada e ka me kompaninë DHL dhe do të thotë se ne i kryejmë vetëm shërbimet për të cilat qeveria krijon humbje ndërsa ato shërbime ku ne mund të kemi një fitim në ato asnjë nuk i marrim. Ne, si Postë e Kosovës, 85 % të tregut e kemi, mirëpo vetëm marrëveshjet që krijojnë shumë të hyra siç është kjo me Ministrinë e Punëve të Jashtme jepen operatorëve privatë rast po

thujse i njëjtë me çështjen e skemave sociale. Kërkesa jonë si Postë e Kosovës është që me na dhënë shërbimet edhe nëse qeveria nuk ka mundësi financiare me i mbuluar shpenzimet që ne i krijojmë për shërbim postar le të na jep shërbimet të tjera që ne jemi në gjendje mi krye. Askush me mirë se ne shërbimin postar nuk e kryen. Në këtë vit e kemi bërë shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë dhe kemi kërkuar letër me shkrim nga të gjitha komunat e Kosovës që me na dërguar letër reference që a jeni të kënaqur me shërbimin dhe mbi 90 % të komunave na kanë dërguar referenca të shkruara se mbi 95 % ka qenë niveli i shpërndarjes.

Fadil Beka: Ju bashkëngjitëm parafolësve, me thënë të drejtën për mua është shumë e pa qartë, e pa konceptuar pse është ky hezitim për ata. Ne kemi diskutuar edhe shumë herë dhe e kemi paraparë edhe takimin me ju edhe ministrat përkatës. Ju si Postë do të thotë se i keni ngritur gjithë ato kapacitete, gjithë atë infrastrukturë, a është fjala vetëm për asistencën sociale apo keni kapacitete mi shpërnda edhe pensionet edhe kontributet e tjera? Ju faleminderit!

Kryetarja: A jeni ankuar në qeveri në mënyrë institucionale për këtë diskriminim nga ana e institucioneve dhe çfarë përgjigjeje keni pranuar?

Sejdi Hoxha – Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës: Realisht i kemi mbi 20 shkresa zyrtare që ju kemi adresuar institucioneve, në këtë rast qeverisë në shkresat tona është përfshirë edhe kryeministri është përfshirë ministri i Zhvillimit Ekonomik i cili është ministër i linjës i cili përfaqëson ndërmarrjet publike. Për shkak të mos marrjes se ndonjë përgjigjeje nga të gjitha institucionet që ju kemi adresuar jemi detyruar që t'i shkruajmë edhe kryetarit të Kuvendit edhe shefave të grupeve parlamentare. Pra, ka qenë një letër publike të cilën e kemi dërguar të gjithë deputetet 120 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës si të zgjedhurit e popullit që mi mbrojtur interesat edhe të qytetarëve të Kosovës edhe të ndërmarrjes publike në këtë rast. Ndërsa sa i përket pyetjes së deputetit z. Beka në fillimisht e kemi diskutuar komplet shpërndarjen e pensioneve dhe skemave sociale, pastaj në bashkëpunim me MPMS-në jemi pajtuar që të bëjmë pilot- projekt dhe të fillojmë vetëm me kategorinë e skemave sociale. Pastaj të shohim se si po shkon dhe pas disa muajve të kthehemi edhe të kategoritë tjera të skemave sociale. Në bazë të një përllogaritje që ne kemi bërë flitet se mbi 3 milionë euro që qeveria shpenzon për shpërndarjen e këtyre skemave edhe për pensione edhe për skema sociale. Pra, më mirë është që këto 3 milionë euro t'i përfitojë një ndërmarrje publike se sa t'i përfitojnë të tjerët në këtë rast. Ne jemi pajtuar që të ndajmë vetëm kategorinë e skemave sociale e kemi shqyrtuar edhe në kuptimin teknik edhe deputetja e ngriti se si ka me u bërë shpërndarja e pensioneve e njëjta gjë ndodh edhe në Shqipëri, pra krijohet një kartelë identiteti të pensionistit në fjalë mjetet financiare derdhen në një llogari bankare e cila menaxhohet nga Ministria e MPMS-së dhe Posta e Kosovës, secili përfitues ose pensionit që e merr pensionin në zyrën postare figuron me automatizëm përmes sistemit dhe i shlyhen mjetet financiare dhe konsiderohet se i ka marrë mjetet financiare, kurse ai pensionist që nuk e ka marrë pensionin për 6 muaj i figuron që nuk e ka marrë pensionin dhe ato mjete janë në atë llogari bankare e cila menaxhohet nga posta dhe Ministria e MPMS-së për këtë çështje kemi marrë edhe konfirmimin nga BQK-ja. Është e vërtetë që postës i mungon vetëm llogaria bankare të gjitha aktivitetet tjera në mundemi mi krye në bazë të licencës që e kemi sikurse bankat vetëm llogarinë bankare nuk e kemi dhe ka rezultuar se mund të menaxhohet përmes një llogarie të përbashkët nëse pensionisti nuk e merr pensionin ato mjete mbesin në atë llogari kur të vjen mundet mi tërheq për 6

muaj përnjëherë edhe për këtë çështje po e them publikisht në jemi të gatshëm me futur në konkurrencë. T'i pyesim pleqtë tanë se apo dëshirojnë me marrë pensionin në postë apo bankë. T'i pyesim qytetaret tanë ku dëshirojnë ata lë të vendosin. Ne kemi pasur një vizitë zyrtare nga Shoqata e Pensionistëve të Kosovës dhe na kanë ofruar mbështetje të plotë dhe kanë kërkuar me letër edhe të ministria edhe të ne që të ju ofrohet pensionisteve që t'i marrin pensionet në zyrat postare.

Kryetarja: Ne konsiderojmë se mjaft e elaburuam këtë çështje dhe u njoftuam direkt nga ju për këtë çështje dhe kemi marrë mjaftë informata dhe në takimin me ministrin e MPMS-së, z. Abrashi do të diskutojmë dhe nga ata do të marrim informata lidhur me këtë çështje. Ju falënderojmë shumë!

Ndërpritet mbledhja e komisionit. Pauzë 15 minuta.

Kryetarja: Përsëritet ministër dhe me lejoni të ju njoftojmë se Komisioni sot ka në diskutim një temë të cilën e ka parashtruar sipas një kërkesë të Postës së Kosovës për shpërndarjen e skemave sociale dhe pse jo edhe të pensioneve. Mendojmë që po diskriminohet posta dhe që nuk është e barabartë në tenderin për afrimin e këtij shërbimi dhe kjo kompani të jetë profitabile, e të mos jetë barrë për Qeverinë. Pra, ne jemi të interesuar përse nuk u nënshkrua marrëveshja që i ishte e gatshme për t'u nënshkruar?

Ministri Abrashi: Falënderoj për ftesën dhe jam i gatshëm të bisedoj për këtë çështje e cila ka marrë një konotacion negativ, edhe pse është një çështje plotësisht teknike dhe për të cilën është punuar gjatë.

Për sqarim të opinionit dhe juve ju njoftoj se asnjëherë nuk ka pasur marrëveshje për këtë çështje, ka pasur diskutime dhe propozime të drafteve për marrëveshje, por marrëveshje të nënshkruar nuk ka. Që në fillim të mandatit kam pritur kryeshefin Ekzekutiv të Postës së Kosovës dhe e kam përkrahur idenë, por i kam treguar se duhet të plotësohen kushtet ligjore.

Është formuar grupi punues teknik i cili ka punuar në vazhdimësi, dhe që është i përbëra nga BQK, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve sociale.

Kam pasur presion ta nënshkruajmë atë marrëveshje, por nuk kam mundur ta nënshkruaj atë marrëveshje pa u sqaruar disa dilema.

Kam një raport nga grupet punuese, dhe do t'ua ju dorëzoj dhe që sulmet që kanë ndodhur ndaj meje nuk përkojnë me njerëzit që udhëheqin institucionet publike, sepse ne kemi një ligj në bazë të cilit duhet të veprojmë. Ne duhet t'i presim konkluzionet dhe rekomandimet e grupeve punues. Nëse rekomandimi i grupeve punuese vjen që mund ta nënshkruaj marrëveshjen, do ta nënshkruajmë menjëherë. Për ta respektuar ligjin, deri sa ta arrijmë marrëveshjen, kemi shpallur tender publik për menaxhimin e këtyre skemave. Deri tani është punuar me marrëveshje të mirëkuptimit, që nga viti 2006.

Konkluzionet nga takimet e grupeve punuese me BQK thuhet se Posta e Kosovës, është institucion financiar, jo bankar(IFJB)e cila mund të afrojë "Shërbimin e transferit dhe pranimin të parave ose shërbimin e pagesave për pagesat brenda dhe jashtë vendit. Mund të realizojë dhe kryejë shërbimet e pagesave, por nëse i referohemi Udhëzimit Administrativ t SNS-se 15/2012, Posta e Kosovës përjashtohet nga mundësi e kryerjes se këtij shërbimi.

Rekomandimi i dytë sipas BQK-së pagesat e skemave sociale duhet të jenë pjesë e Sistemit Ndërbankar të Pagesave të BQK-së.

Bazuar në opinionin e BQK-se Institucionet Financiare jo Bankare të licencuara nga ana e BQK-së (6), asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk janë aktualisht pjesëmarrës direkt të Sistemit Ndërbankar të Pagesave në BQK. Të njëjtat institucione për shërbimet e kliringut dhe shlyerjeve, veprojnë përmes

bankave komerciale me të cilat kanë marrëveshje për operacione të kliringut dhe shlyerjeve finale në llogari.

Ne kemi pasur takime edhe me thesarin dhe konkluzionet e tyre ishin që çështjet e transfereve të pagesave për klientët dhe përfituesit janë përgjegjësi e organizatës buxhetore dhe se Thesari urdhëron transferin e mjeteve të përfituesi-klienti ashtu sikurse përcakton organizata buxhetore.

Bazuar në legjislacionin në fuqi (Udhëzimin Administrativ 15/2012), mënyra e transferit të pagesave për përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale është e përcaktuar që të bëhet në xhirollogari bankare, përmes ndonjëres prej Bankave Komerciale. Me këtë rast Posta e Kosovës, përjashtohet nga mundësia e kryerjes së këtij shërbimi të pagesave sepse nuk ofron mundësi të xhirollogarive bankare.

Sipas Ligjit mbi Përgjegjësitë e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi, Thesari ka dhënë opinion se shpenzimi i parave publike, mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin, i cili është themeluar nga aktet nënligjor. Sipas Thesarit të Kosovës, bazuar në LPMFPP nenin 17, paragrafi 17.2 “Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga aktet nënligjore, sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji.” *Transferet për individët përfshijnë programet e mirëqenies sociale, siç janë pensionet (shih Udhëzimin Administrativ 2005/08) dhe pika 5. “Pagesat e subvencioneve dhe transfereve duhet të bëhen përmes transfereve bankare”.*

Bazuar në të drejtat që ka për kryerjen e shërbimit të pagesave Posta e Kosovës është (IFJB), mund të pranojë shumën e mjeteve nga MPMS dhe Thesari, përmes transferit bankar, por Posta e Kosovës nuk mund të kryejë transfere bankare të familja dhe individit, si përfituese e ndihmës sociale dhe as të krijojë xhirollogari siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ 15/2012, për realizimin e pagesave të asistencës sociale.

Rekomandimet e grupit punues për menaxhmentin e MPMS-se kanë qenë:

Zhvillimi i takimeve në mes të menaxhmentit të MPMS-së dhe menaxhmentit të Postës, për të diskutuar konkluzionet e dala nga takimet e grupit punues.

Pagesa e ndihmave sociale duhet të bëhet në xhirollogari bankare të përfitueseve, për këtë Posta e Kosovës të afrojë garanci dhe dëshmi paraprake, që mund të kryej këtë shërbim.

MPMS themelon grupin punues për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 15/2012, për realizimin e pagesave të asistencës sociale.

Pas aprovimit të plotësim ndryshimeve të Udhëzimit Administrativ 15/2012, për realizimin e pagesave për asistencë sociale, MPMS zhvillon procedurat e prokurimit për shpërndarjen e skemës së ndihmës sociale në harmoni me ligjin e prokurimit dhe plotësim ndryshimet e Udhëzimit Administrativ.

Këto janë çështje teknike që do t’i ndaj me ju, unë ju them që ekziston vullneti për t’u realizuar kjo kërkesë e Postës, por duhet të kryhen obligimet ligjore sipas kërkesave dhe monitorimit të rrjedhjes së parash publike.

Kryetarja: Ne kemi disa dokumente nga drejtori i thesarit ku thonë se dakordohen me projekt marrëveshjen në mes MPMS dhe Postës së Kosovës.

Gjithashtu kemi edhe dokumentin tjetër që posta nuk i nënshtrohet procesit konkurs të prokurimit sepse mjetet mund të kontrollohen nga thesari. Ka edhe dokumente tjera që e demantojnë këtë dhe infrastrukturën e postës e njohim të gjithë. I shohim edhe rreshtat e gjata të përfituesve të skemës sociale dhe një pasqyrë jo humane e këtyre njerëzve duke i marr skemat sociale. Këtë çështje e kemi shtruar edhe më herët pa marrë kërkesën e postës.

Edhe ju po e pranoni se një mundësi e tillë e pagesës së skemave sociale përmes postës edhe mund të ekzistoj.

Arban Abrashi: Edhe thesari vepron në kuadër të Ministrisë së Financave dhe unë nuk mund të bazohem në shkresa të zyrtarëve por duhet ta marr konfirmimin e Ministrit të Financave dhe Guvernatorit që procesi është në rregull, atëherë unë do të nënshkruaj marrëveshjen me Postën. Thesari është pjesë e grupit punues dhe konkluzionet e takimeve të grupit punues nuk korrespondojnë me e-majlet e dërguara para se me qenë unë ministër.

Jemi që ta zgjidhim çështjen por duhet ta zgjidhim ligjërisht dhe se duhet t'i ndërrojmë ligjet dhe udhëzimet administrative.

Kryetarja: Ky komision a është formuar para apo pas hartimit të projekt marrëveshjes, pasi kemi informatë që marrëveshja ka dështuar të nënshkruhet një orë para kohës së dakorduar për nënshkrim të marrëveshjes.

Besa Baftiu: E ceku edhe kryetarja se vetëm një orë para nënshkrimit është prishur draft-marrëveshja. Ju a nuk e keni ditur që keni pengesa ligjore, dhe në momentet e fundit jeni tërhequr. I dëgjuam nga menaxhmenti i postës ata kanë plotësuar tri kriteret, si nga BQK, nga thesari i shtetit dhe nga KRPP. Pra, t'i dimë shkaqet e dështimit të marrëveshjes, pasi edhe zëvendësministrja ka paralajmëruar nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

Arban Abrashi: Për shkaqe të sigurisë së parasë publike dhe për shkak të çështjeve ligjore nuk kemi mundur ta arrijmë marrëveshjen. Posta duhet të bëj marrëveshje me bankat tjera apo të bëj marrëveshje tjera për ta hequr kliringun. Ne jemi në proces që të gjithë t'i arrijmë përmbushjen e kriterëve ligjore se nuk mund të arrijmë marrëveshje në kundërshtim me ligjin.

Edhe nëse lejohet që institucionet jo-bankare t'i shpërndajnë këto pagesa prapë ndoshta duhet të hapim tender ku mund të konkurrojnë edhe institucione tjera jo-bankare me çmime më të volitshme se Posta. Krejt këto procedura duhet të zhvillohen në pajtim me ligjin.

Fikrim Damka: Qëllimin të gjithë e kemi të njëjtë të ndihmojmë një ndërmarrje publike që ta kryej shërbimin më të mirë të mundshëm në tërë territorin e Kosovës. Si Komision kemi iniciuar diskutimin e kësaj kërkesë që të dëgjojmë nga të gjitha palët. Ne do të diskutojmë edhe me BQK dhe me Ministrin e Financave se cilat janë pengesat ligjore për realizimin e kësaj kërkesë. Nëse është e nevojshme ndryshimi i ndonjë ligji, ne do të ndryshojmë ndërsa Udhëzimet Administrative ju do t'i ndryshoni. Sa për sigurinë kjo është një ndërmarrje publike e cila duhet të ketë një siguri dhe që ka një qarkullim vjetor prej 100 milionë euro atëherë duhet të ketë siguri të mjaftueshme edhe për shpërndarjen e skemave sociale. Ky komision teknik i formuar duhet sa më shpejt të dalë me konkluzione, ndërsa ne si deputetë duhet të dalim me disa rekomandime konkrete.

Arban Abrashi: Kemi një vendim të OSHP që thotë që procesi pjesërisht është i bazuar dhe fton me shkuar procesi në ritenderim, eksperti i OSHP ka dhënë mendim me vazhduar procedura.

Kryetarja: Por bordi i OSHP, merr vendim.

Arban Abrashi: Po vendimi i bordit thotë pjesërisht ka të drejtë, nuk ka thënë të anulohet tenderi, por ne në vullnet të mirë kemi formuar komisionin teknik, në mënyrë që të mos bëhet ndonjë shkelje. Ky grup punues duhet edhe pak kohë të punoj dhe të gjinden mundësit të gjejnë një zgjidhje.

Kryetarja: Kjo çështje do të debatohet edhe në Kuvend dhe të vendoset se a duhet të ndryshohet ndonjë ligj. Për Komisionin tonë më të rëndësishmit janë përfituesit e skemës sociale të cilët do t'i mbështesim që të mos presin në radhë. Pastaj ta përkrahim edhe Posten, si kompani publike. Si bëhet shpërndarja e skemave sociale në vendet e rajonit.

Arban Abrashi: Postat e rajonit ndoshta plotësojnë disa kriteret, ndoshta kanë depozita bankare, kanë xhirollogari dhe kanë licenca bankare, kështu që nuk mund të krahasohen.

Kryetarja: Ne e mirëpresim konkluzionin e komisionit të formuar për këtë çështje, por ne do të diskutojmë edhe me BQK dhe me Ministrin e Financave, sepse janë shumë vendime kontradiktore dhe na vënë edhe ne në dilema.

Izedin Bytyçi – Sekretar MPMS: Nuk ekziston ndonjë interes i lartë i bankave për këtë tender. Problematika është që çështja të rregullohet mirë ligjërisht e të mos kemi pastaj ndonjë rekomandim negativ nga auditorët apo nga ndonjë institucion tjetër. Transferet deri te individë duhet të shkojnë përmes llogaris bankare. Posta mundet të bëjë ndonjë marrëveshje me ndonjë bankë komerciale. Posta duhet t'i rregulloj dokumentacionin konform ligjit e pastaj ne do të kryejmë pjesën që i takon MPMS.

Kryetarja: Për ne është më interes edhe mbrojtja e një kompanie shtetërore që ajo të punojë e të mos jetë barrë e qeverisë.

Hatim Baxhaku: Desha të sqaroj që të mos ketë keqkuptime unë nuk jam kundër që Posta ta kryej këtë shërbim, por shprehja disa hezitime të mija se a mund të realizohet kjo çështje?

Arban Abrashi. Ne nuk mund të kalojmë nga një ekonomi formale në një ekonomi informale sepse unë po kritikona në raportin e auditimit. Rrjedha e parasë publike duhet të shkojë përmes një sistemi transparent deri te klienti.

Ne për të qenë transparent, kemi shpall tenderin për realizimin e shpërndarjes.

Kryetarja: A bëhet shpërndarja e asistencës sociale dhe pensioneve nga një bankë apo nga banka të ndryshme?

Arban Abrashi: Asistenca sociale shpërndahet vetëm nga një bankë, ndërsa pensionet nga banka të ndryshme varësisht se ku dëshirojnë pensionistët.

Fikrim Damka: Ne lavdërojmë punën tuaj si ministër në këtë Ministri dhe keni bërë shumë kursime në çdo aspekt. E dimë që keni një vullnet të mirë që të kryeni edhe këtë çështje, por mendoj se keni hapësirë edhe të legjislacionit që të filloni me një pilot- projekt. Do ta kishim pa të gjithë se a mund të funksionoj ky projekt? Sa i përket ndryshimit të legjislacionit, nëse kemi një vullnet të përbashkët për ta rregulluar këtë çështje atëherë do ta ndryshojmë legjislacionin. Posta nuk mund ta ndryshoj legjislacionin. Nëse bankat nuk janë të interesuara ta kryejnë këtë çështje, atëherë ta kryejmë përmes postës. Ne duhet ta ndihmojmë një ndërmarrje publike.

Fatmir Haxholli: Ministri ka shprehur vullnet të përmbushë kërkesën e postës dhe të kursej mjete publike, por edhe në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve publike, por ne duhet të operojmë në një ambient ligjor.

Nëse guvernatori i BQK thotë po do të realizohet, edhe Ministri i Financave pajtohet atëherë ministri Abrashi nuk ka ndonjë arsye ta refuzojë dhe kjo do të realizohet. Sepse nuk mundet ministri të ndërmarr veprime që do të akuzohet për shkelje ligjore.

Nuk jemi të kënaqur me shërbimin e shpërndarjes së skemave sociale dhe pensioneve por korniza ligjore e ka përcaktuar mënyrën e shpërndarjes.

Realisht Posta e Kosovës i ka shtyrë disa pozicione të cilat ministri nuk i ka kundërshtuar, por nënshkrimi i marrëveshjes është në proces të diskutimit të ligjshmërisë. Marrëveshja pa u nënshkruar nuk krijon obligime.

Arban Abrashi: Edhe një herë po e cek se ne kemi vullnet politik për arritje të marrëveshjes me Postën, sa i përket kritereve dhe rregullativës ligjore mbetet të përmbushen nga aktorët tjerë të përfshirë në proces.

Fikrim Damka: Kush e ka iniciuar draft- marrëveshjen për pilot projektin?

Arban Abrashi: Si duket draft- marrëveshja është iniciuar nga ministri paraprak, por edhe ai ka hezituuar ta nënshkruaj marrëveshjen.

Flora Brovina: Po zëvendësministria a ka qenë e njoftuar me procesin, sepse ka pasur një prononcim që do të arrihet marrëveshja dhe do të fillojë pilot- projekti?

Arban Abrashi: Unë kam diskutuar me kryetarin e Shtimes që të fillojmë me pilot- projektin e shpërndarjes së ndihmave sociale përmes postës në Shtime. Por kur kemi filluar me shqyrtimin e ligjshmërisë e kemi parë se ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nënshkrim të marrëveshjes.

Flora Brovina: Grupi punues që po merret me këtë çështje kur do të përfundojë punën dhe kur do t'i kemi rekomandimet e këtij grupi punues.

Sekretari: *Besoj se deri në shtator do ti keni rekomandimet e grupit punues.*

Mirjeta Kalludra: *Përfaqësuesit e postës deklaruan që afati i tërheqjes së skemës sociale nga banka është dy ditë, a jeni të informuar se sa ditë i kanë përfituesit në dispozicion ta tërheqin këtë skemë sociale.*

U cek se edhe disa nga këta përfitues nuk kanë llogari bankare, a janë të vërteta këto pohime?

Arban Abrashi: *Secili përfitues ka xhirollogari të hapur. Ne ju hapim xhirollogari të gjithë përfituesve. Ky është një proces që përmes bankave ne i kontrollojmë të gjitha pagesat deri te përfituesit dhe nëse parat nuk tërhiqen na kthehen prapë në thesar brenda afatit të paraparë, brenda atij muaji.*

Fadil Beka: *Falënderoj që gjithmonë je përgjigjur në ftesën tonë dhe na ke informuar hollësisht për çështjet për të cilat të kemi ftuar. Nuk e kam pasur as dilemën që nuk e ke gatishmërinë, por pasi i përmendet proceset ligjore, ne nuk jemi për shtyrje të proceseve duke bërë shkelje të ligjeve. Nëse diçka varet nga ne, ne do ju përkrahim e ndoshta edhe të bëjmë edhe diskutim në Parlament, apo ta marrim iniciativën ta ndryshojmë ndonjë ligj që e shihni të nevojshme.*

Arban Abrashi: *Çështjen e menaxhimit të mjeteve financiar unë nuk i njoh, por e di që Posta për t'i shpërnda skemat sociale duhet të bëhet pjesë e sistemit ndërbankar.*

Kryetarja: Qëllim i joni është ta gjejmë ku qëndron problematika. U tha se nëse ka nevojë të ndryshohet ndonjë ligj ne do ta ndryshojmë.
Ju falënderoj për përgjigje në ftesën tonë dhe për gatishmërinë për bashkëpunim.

3. Të ndryshme:

Kryetarja: A keni ndonjë çështje për të diskutuar për pikën: të ndryshme?

Fikrim Damka: Propozoj që për pikën që sot e diskutuam ta kemi edhe një takim me BQK dhe me Ministrin e Financave.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që kryetarja dhe dy nënkryetarët të takohen me Ministrin e Financave dhe me Guvernatorin e BQK- së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA